REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL

Nr. 11243-02180-00-2011 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2014-3680 i Vendimit (623)

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian NUNI	**Kryesues**
Guxim ZENELAJ	**Anëtar**
Mirela FANA	**Anëtar**

në seancën gjyqësore të datës 27.11.2014 mori në shqyrtim çështjen civile me Nr. 02180/11, që u përket palëve:

KËRKUES:	**"RAI RADIOTELEVISIONE ITALIANA" Spa,** *përfaqësuar nga avokat Gerhard Velaj*
PERSON I TRETË:	**"ALBTELEKOM" SHA,** *përfaqësuar nga juristja Suela Zyberaj*
OBJEKTI:	*Njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit nr. 11494/03, datë 20.03.2003 të Gjykatës së Romës, Itali.*
BAZA LIGJORE:	*Nenet 393, 395, 397 e vijues të K.Pr.Civile.*

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 93, datë 20.07.2011, ka vendosur:
"Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Rai-RadioTelevisionne Italiana për njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit Nr. 11494/03, datë 20.03.2003, së Gjykatës së Romës, Itali".

Kundër vendimit Nr. 93, datë 20.07.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur rekurs kërkuesi Rai-Radio Televisione Italianna, që kërkon prishjen vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, për këto shkaqe:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është rezultat i mosrespektimit të ligjit dhe zbatimit të keq të tij sipas nenit 472/a të Kodit të Procedurës Civile.
- Në rastin konkret, nuk jemi para asnjë prej pengesave ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile.
- Meqenëse, RAI në marrëdhënien kontraktore me Albtelecom, ka marrë përsipër t'i ofrojë shërbime kësaj të fundit (në lidhje me përdorimin e qarqeve të videove ndërkombëtare) atëherë bazuar në ligjin e përmendur me lart, rezulton se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje është ai italian.
- Konventa e Romes 1980, "Mbi ligjin e aplikueshëm në lidhje me detyrimet kontraktore" (e cila është pjesë e legjislacionit italian), përcakton se në rast se ligji i aplikueshëm nuk është zgjedhur nga palët, atëherë kontrata do të rregullohet nga ligji i vendit me të cilin kontrata është e lidhur me ngushtësisht. Sipas paragrafit 2 të nenit 4 të Konventës, do të konsiderohet se kontrata është e lidhur më ngushtë me vendin, ku pala që do të kryejë shërbimin, objekt kontrate, në kohën e lidhjes së kontratës ka vendbanimin e saj të zakonshëm, ose në rastin e personave juridikë, selinë qendrore.
- Një pretendim tjetër i shoqërisë Albtelecom, shqyrtuar nga Gjykata e Apelit ka qenë se, pala e paditur në vendimin e Gjykatës së Romës (Telecom Albanian, International Services Department) nuk është i njëjti person juridik me shoqërinë Albtelecom dhe kjo e fundit nuk është njoftuar asnjëherë nga Gjykata e Romës në lidhje me këtë proces.
- Telecom Albanian, International Services Department (emri i të padituri në vendimin e Gjykatës së Romës) dhe Albtelecom Sh.A janë i njëjti person juridik. Telecom Albanian është versioni në anglisht i emrit të shoqërisë Albtelecom, ndërsa International Services Department është emri i Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë pranë shoqërisë Albtelecom.
- Njoftimet i janë bërë Albtelecom në lidhje me këtë proces nga Gjykata e Romës ashtu edhe nga RAI dhe janë dërguar në selinë e kësaj shoqërie në adresën e deklaruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- Vendimi i Gjykatës së Romës në përmbajtjen tij nuk asnjë papajtueshmëri me parimet bazë të legjislacionit shqiptar. Në rastin konkret forma e prerë e vendimit të gjykatës i është dhënë në përputhje me legjislacionin italian i cili është ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe konkretisht nenit 133 të Kodit të Procedurës Italiane. Sipas parashikimeve të kësaj dispozite komunikimi i për palët në mungesë realizohet nëpërmjet publikimit të vendimit në kancelarinë e gjykatës.
- Në mbështetje të nenit 327, të Kodit të Procedurës Civile në të cilin parashikohet se pavarësisht njoftimit, rekursi ë gjykatën e Lartë apo shfuqizimi për arsyet e përcaktuar në pikën 4 dhe 5 të nenit 395 të Kodit, nuk mund të zbatohen pasi kanë kaluar gjashtë muaj nga publikimi i vendimit. Ky afat nuk mund të zbatohet kur pala në mungesë provon se nuk ka pasur dijeni për gjykimin për shkak të mos njoftimit të padisë dhe njoftimit në gjyq. Në rastin konkret Albtelecom është njoftuat rregullisht në lidhje me zhvillimi e procesit gjyqësor në Gjykatën e Romës.

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ardian Nuni; përfaqësuesin e palës paditëse, avokatin Gerhard Velaj, që kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit; përfaqësuesen e personit të tretë, juristen Suela Zyberaj, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Pala kërkuese e këtij gjykimi, RAI-Radio Televisione Italianna, ka parashtruar se midis saj dhe personit të tretë "Albtelekom" SHA, në vitin 1996 është rënë dakort që RAI-Radio Televisionne Italiana t'i jepte me qira "Albtelekom" SHA, qarqet video ndërkombëtare.

2. Pala kërkuese RAI-Radio Televisionne Italiana, me pretendimin se, ndonëse ajo i plotësoi detyrimet e veta kontraktore lidhur me dhënien me qira të video ndërkombëtare, nga ana e shoqërisë "Albtelekom" SHA, nuk janë bërë pagesat përkatëse, me padi paraqitur para Gjykatës së Romës, ka kërkuar pagimin e detyrimit kontrakator në shumën 15.529,76 Euro dhe interesat mbi këtë shumë deri në datën e pagesës së detyrimit.

3. Gjykata e Romës, me vendimin nr. 11494/03 datë 20.03.2003 ka vendosur detyrimin e shoqërisë "Albtelekom" SHA t'i paguajë "RAI-Radio Televisione Italiana" Spa shumën 15.529,76 Euro, interesat nga 15 maj 1999 deri në datën e pagesës, pagesat për shpenzimet 92,96 Euro, për të drejtat 826,33 Euro, për honoraret 1291,14 Euro, si dhe pagesat për aksesorët fiskalë dhe sigurimet e rimbursimet, shpenzime të përgjithshme sipas ligji.

4. Pala kërkuese, RAI-Radio Televisione Italiana, me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Romës ka marrë formë të prerë dhe është i ekzekutueshëm, me kërkesën e datës 25.02.2011 ka kërkuar: "*Njohjen e vendimit përfundimtar të Gjykatës së Romës, Itali, nr. 11494/03 datë 20.03.2003, për çështjen civile me palë paditëse RAI-Radio Televisione Italiana, i paditur ALBTELECOM Sh.A."*

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 93, datë 20.07.2011, ka rrëzuar kërkesën *"...për njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit Nr. 11494/03, datë 20.03.2003, së Gjykatës së Romës, Itali"* .

5.1. Në rrëzimin e kërkesës gjykata e apelit, pasi ka administruar një kopje në gjuhën italiane të vendimit të Gjykatës së Romës të çertifikuar më datë 24.05.201, ka parashtruar: - *"…vendimi i gjykatës është përkthyer nga italishtja në shqip nga përkthyese zyrtare e autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me nenin 4/2 të Konventës "Për njohjen dhe ekzkeutimin e vendimeve të huaja të Arbitrazhit (Konventa e New Yorkut 1958), vërtetua kjo nga noteri..."*; - *"...,me Shkresën nr. 3971/1 prot., datë 20.05.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfirmohet fakti se para kësaj gjykate nuk kishte për gjykim çështje civile, ku të ishte palë Rai Radio Televisione Italianna"*; - *"..., rezulton se ekzistojnë pengesat që parashikohen në nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile, ashtu sikundër ndonjë prej pengesave të parashikuara në nenin 5 të Konventës "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të Arbitrazhit (Konventa e New*

Yorkut 1958), Konventë në të cilën aderon dhe Republika e Shqipërisë sipas Ligjit nr. 8688, datë 09.11.2000"; - *"...,referuar nenin 394 në lidhje me nenin 399 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton që: "Sipas dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit italian dhe kjo përbën pengesë për zgjidhjen të mosmarrëveshjes mes palëve ndërgjyqëse"*; - *"Provohen pretendimet nga personi i tretë Albtelekom Sh.a., për mos sigurimin e garancive të nevojshme për t'u mbrojtur gjatë gjykimit të mosmarrëveshjes nga gjykata e huaj; Kërkesë padia dhe flet-thirrjet për në gjyq nuk i janë njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt, e në kohë, për t'i dhënë atij mundësinë për t'u mbrojtur"*; - *"Vendimi i gjykatës së huaj objekt njohje nuk ka marrë formë të prerë sipas rregullave të legjislacionit të vendit të tij. Vendimi i gjykatës së huaj si më lart në pamundësi të njoftimit nuk është apeluar sipas ligjit të vendit ku është zhvilluar procedura e gjykimit"*; - *"Vendim i gjykatës të huaj është në kundërshtim me parimet bazë të legjislacionit shqiptar, pasi nuk rezulton e provuar ekzistenca e kontratës së porosisë e lidhur mes palëve e për pasojë nuk njihen të drejtat dhe detyrimet e palëve përcaktuar nga kjo kontratë"*; - *"Kështu, referuar nenit 5/1 të Konventës "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të Arbitrazhit (Konventa e New Yorkut 1958), personi i tretë në këtë gjykim..., pra pala kundër së cilës drejtohet njohja dhe ekzekutimi i vendimit të gjykatës së huaj, pretendoi dhe provoi për sa më sipër"* dhe për rrjedhojë gjykata ka çmuar *"...se njohja dhe ekzekutimi i vendimit të gjykatës së huaj vjen në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Shqipërisë"*.

6. Kundër vendimit nr. 93, datë 20.07.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs kërkuesi Rai-Radio Televisione Italianna, me të cilin kërkon prishjen vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, për shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

LIGJI I ZBATUESHËM

7. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile në të cilat është parashikuar:

7.1. Neni 14 i K.Pr.Civile: *"Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin"*.

7.2. Neni 16§1 i K.Pr.Civile: *"Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët"*.

7.3. Neni 29 i K.Pr.Civile: *"Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore.*
Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes".

7.4. Neni 126§2 i K.Pr.Civile: *"Vendimi përfundimtar, si dhe vendimet që i japin fund procesit gjyqësor civil të parashikuara prej nenit 127 të këtij Kodi jepen në "Emër të Republikës" dhe përkatësisht duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes të saj"*.

7.5. Neni 310/II i K.Pr.Civile: *"Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të*
përmenden: 1) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit, dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata, 2) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, 3) dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi".

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË VLERËSON

8. Se rekursi i paraqitur nga pala kërkuese "Rai-Radio Televisione Italiana" Spa përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile që motivojnë cenimin e vendimit nr. 93, datë 20.07.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në shqyrtim të akteve procedurale, objektit dhe shkakut të padisë, pretendimeve e prapësimeve të pjesëmarrësve në gjykim, të vendimit të gjykatës së apelit, shkaqeve të rekursit dhe parashtrimeve në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë, arrin në përfundimin se vendimi nr. 93, datë 20.07.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë është rrjedhojë e mosrespektimit të ligjit dhe për këtë shkak duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim po pranë kësaj gjykate.

10. Gjykata e Lartë, pa i hyrë analizës së provave, nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore dhe pretendimeve të parashtruara në rekurs evidenton nëse nga gjykatat e faktit janë lejuar ose jo shkelje të normave procedurale dhe nëse ligji material është respektuar ose jo. Në varësi të zgjidhjes së këtyre çështjeve nga gjykatat e faktit, Gjykata e Lartë, në realizim të funksionit të saj rishikues, shprehet për bazueshmërinë ose jo në ligj të vendimeve të gjykatave të faktit.

10.1. Vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e mosrespektimit të neneve 10, 11, 14, 16, 29, 126 e 310 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilëve gjykata mbështet vendimin mbi faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, të marra në seancë gjyqësore, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që për rastin lidhen me ekzistencën ose jo të pengesave ligjore për njohjen dhe dhënien fuqi një vendimi të një gjykate të huaj, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë pjesëmarrësit në proces gjyqësor dhe zgjidh atë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

10.2. Nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit të gjykatës së apelit evidentohet se kjo gjykatë ka dalë me vendimmarrje pa bërë një analizë tërësore dhe objektive të fakteve dhe provave që mbështesin bazueshmërinë ose jo të kërkesës për njohjen e vendimit të një gjykate të huaj, konform kërkesave të nenit 126 dhe pikave 1 dhe 2 të nenit 310/II të Kodit të Procedurës Civile.

10.3. Evidentohet se vendimi i gjykatës përmban vetëm konkluzione dhe nuk jepet asnjë arsyetim mbi bazën e të cilave janë nxjerrë këto konkluzione, me përjashtim të faktit që, sipas shkresës nr. 3971/1 prot., datë 20.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranë kësaj gjykate *"...nuk figuron të ketë regjistruar çështje civile me palë paditës: Rai-Radio Televisione Italianna, të paditur: ALBTELECOM sh.a."* (germa "ç" e nenit 394 i K.Pr.Civile).

11. Në rrethanat e mësipërme, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimit të gjykatës së apelit i mungon argumentueshmëria, që do të thotë se vendimi nuk përputhet plotësisht me të dhënat objektive të çështjes dhe për rrjedhojë është dhe i pambështetur në ligj.

11.1. Gjithashtu, ky kolegj vlerëson se vendimit të gjykatës së apelit i mungon arsyetimi, ç'ka ka sjellë dhe mosdhënien e arsyeve ligjore të rrëzimit të kërkesës. Arsyetimi i vendimit është detyrim

i sanksionuar ne nenin 142/1 të Kushtetutës dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, mosrespektimi i të cilave pas sjell prishjen e tij.

12. Ky Kolegj e gjen me vend të parashtrojë se procesi civil, ashtu si ai i gjykimeve me palë kundërshtare edhe ai i gjykimeve të posaçme, ka për qëllim zhvillimin e një gjykimi që konsiston në vlerësimin nga pikëpamja e së drejtës të një fakti ose një grup faktesh, por domosdoshmërisht këto të fundit para se të vlerësohen nga gjykata duhet të vërtetohen. Në të kundërt, sikundër është rasti konkret, vendimi nuk është i argumentuar dhe as i bazuar në ligj.

12.1. Mosrespektimi i ligjit procedural në procesin e marrjes, analizës dhe çmuarjes së drejtë dhe të saktë të provave ka bërë që gjykata e apelit të mos përcaktojnë në përputhje me ligjin provat që janë të domosdoshme e që kanë lidhje me çështjen në gjykim, vërtetësinë e tyre në lidhje me faktet që kërkohet të vërtetohen, rëndësinë dhe fuqinë provuese të tyre.

12.2. Gjykata e apelit nuk ka respektuar kërkesat e nenit 213 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me nenet 11 dhe 12 të po këtij Kodi. Gjykata kishte detyrimin ligjor që, pasi të dëgjonte pretendimet e kërkuesit dhe të personit të tretë, të merrte një vendim të ndërmjetëm për të lejuar administrimin e provave, në mënyrë që ato t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor.

13. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë sjell në vëmendje të gjykatës së apelit se gjykimi për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja është një nga llojet e gjykimeve të posaçme, parashikuar nga dispozitat e Kreut IX, Titulli III, Pjesa e Dytë e Kodit të Procedurës Civile, në të cilin, përveç rregullave të përgjithshme të gjykimit, zbatohen edhe rregullat e posaçme të parashikuara nga këto dispozita (nenet 393-399).

13.1. Në respektim të këtyre dispozitave gjykata kishte detyrimin ligjor të evidentonte, të verifikonte dhe të argumentonte në vendimin e saj rrethanat e faktit që kanë të bëjnë me ekzistencën ose jo të pengesave ligjore për njohjen dhe dhënien fuqi vendimit të një gjykate të huaj.

14. Ndonëse gjykata ka arritur në konkluzionin se*"Sipas dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit italian dhe kjo përbën pengesë për zgjidhjen të mosmarrëveshjes mes palëve ndërgjyqëse..."*, nuk jep asnjë argument me të cilin të jetë vërtetuar që gjykata italiane që ka dhënë vendimin nuk ka qenë "kompetente" [**1**] për shqyrtimin e çështjes konkrete sipas parimeve të "kompetencës" gjyqësore të së drejtës së shtetit shqiptar.

14.1. Kjo nuk do të thotë që gjykata të verifikonte ekzistencën e "kompetencës" gjyqësore të gjykatës italiane në bazë të ligjit italian, por të arsyetonte nëse gjykata italiane ka gjykuar ose jo në bazë të kritereve, që sipas legjislacionit shqiptar do të mund të përcaktonin juridiksionin e gjykatave shqiptare.

[**1**] Pavarësisht se në nenin 394 gërma "a" përdoret termi "competence", në kuptim të legjislacionit shqiptar kemi të bëjnë me "juridiksion", të gjykatave shqiptare apo të gjykatave të huaja.

15. Gjithashtu, gjykata e apelit ka arritur në konkluzionin se personi i tretë provoi *"...mos sigurimin e garancive të nevojshme për t'u mbrojtur gjatë gjykimit të mosmarrëveshjes nga gjykata e huaj; Kërkesë padia dhe flet-thirrjet për në gjyq nuk i janë njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt, e në kohë, për t'i dhënë atij mundësinë për t'u mbrojtur"*, por këtë konkluzion nuk e mbështet në asnjë argument ligjor, të analizuar e të vlerësuar sipas bindjes së saj të brendshme. Ndonëse hetimi i gjykatës përsa parashikon gërma "b" e nenit 393 të Kodit të Procedurës Civile është diskrecional, gjykata i nënshtrohet detyrimit për ta arsyetuar atë, pasi kjo lidhet pazgjidhshmërisht me procesin e rregullt ligjor.

16. Më në fund, gjykata e apelit ka arritur në konkluzionin *"...se njohja dhe ekzekutimi i vendimit të gjykatës së huaj vjen në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Shqipërisë"*. Ky kolegj e vlerëson edhe këtë konkluzion të paargumentuar. Gjykata në arritjen e këtij konkluzioni nuk ka dhënë asnjë arsye ligjore që përmbajtja e dispozitivit të vendimit të gjykatës italiane cenon parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

16.1. Në këtë drejtim vlen të theksohet se nuk ka rëndësi rregulli i normës juridike italiane që është zbatuar nga gjykata italiane, por vetëm efektet e mundshme që rrjedhin nga njohja dhe dhënia fuqi e vendimit gjyqësor të kësaj gjykate dhe përputhshmëria e tyre me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

17. Përsa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr. 93, datë 20.07.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet për rishqyrtim po kësaj gjykate me tjetër trup gjykues.

18. Në vlerësim të natyrës juridike të kërkesës së paraqitur, shkakut të saj, në mbështetje të neneve 465, 486 e 493 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata, duke mbajtur parasysh konkluzionet e mësipërme të këtij vendimi, duhet të verifikojë e të evidentojë me argumente ligjore ekzistencën ose jo të pengesave ligjore të parashikuara në nenin 394 të po këtij Kodi; nëse për rastin janë të qenësishme këto pengesa, sikurse pretendohet nga personi i tretë apo jo.

18.1. Për zgjidhjen e drejtë të këtyre problemeve, gjykata, në respektim të nenit 213 në lidhje me nenet 11 e 12 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të përcaktojë me vendim për secilin pjesëmarrës në gjykim faktet që duhet të provohen prej tyre, provat që lejohen të paraqiten nga secila palë veçmas, vlerën provuese të secilës prove, si dhe barrën e provës për secilën palë.

18.2. Në rigjykim, gjykata, për t'iu dhënë zgjidhje problemeve të mësipërme, në respektim të të drejtave të palëve dhe detyrimeve të tyre që rrjedhin nga procesi gjyqësor civil, ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin (neni 14) dhe, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen ta zgjidhë atë *"në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi"* (neni 16).

18.3. Gjykata t'u bëjë të qartë palëve se është detyrë e secilës prej tyre, që në përputhje me ligjin, të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për të provuar faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet. Në zgjidhjen e drejtë e ligjore të çështjes, ashtu si palët/pjesëmarrësit kanë të drejta, ato kanë dhe detyrime *"që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara"* në Kodin e Procedurës Civile (neni 3).

19. Kryerja e veprimeve të mësipërme, si dhe e të tjerave që eventualisht mund të dalin gjatë rigjykimit, do ta lejojnë gjykatën, që në përputhje me kërkesat e ligjit procedural e atij material të mund të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive, lidhur me zgjidhjen e çështjes.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile.

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. 93, datë 20.07.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 27.11.2014

A N Ë T A R	**A N Ë T A R**	**K R Y E S U E S**
Kundër		
Mirela FANA	**Guxim ZENELAJ**	**Ardian NUNI**

Vërtetohet njësia me origjinalin P.Adm.Gjyq. D.Qerimi F.M.

MENDIMI PAKICE

Unë, gjyqtare Mirela Fana, si gjyqtare në pakicë, nuk jam dakort me vendimin nr. 623, të datës 27.11.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (shumica) me të cilin është vendosur "Prishja e vendimit nr. 93, datë 20.07.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues".

Kam mendimin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile që motivojnë cenimin e vendimit nr. 93, datë 20.07.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kolegji Civil duhet të kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.93 datë 20.07.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Vendimi i gjykatës së apelit është marrë në kushtet *"një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin" (neni 14 i K.Pr.Civile*), duke i dhënë përgjigje pretendimeve të palëve, në një analizë të plotë dhe objektive të provave, (neni 126 i K.Pr.Civile), duke e zgjidhur "*mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj "*, (neni 16 i K.Pr.Civile), për aq sa nga gjykatat është hetuar dhe i është dhënë përgjigje pretendimeve të palëve ndërgjyqëse mbi kushtet e nevojshme të parashikuara nga ligji procedural për njohjen dhe dhënien fuqi vendimit gjyqësor të një gjykate të huaj në Republikën e Shqipwrië.

Kështu siç ka rezultuar e provuar, kërkuesi RAI-Radio Televisione Italiana me anë të kërkesës së datës 25.02.2011 i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë mbi njohjen e vendimit të Gjykatës së Romës, Itali, nr. 11494/03 datë 20.03.2003, për çështjen civile me palë paditëse RAI-Radio Televisione Italiana, i paditur ALBTELECOM Sh.A.

Kërkuesi RAI-Radio Televisione Italiana ka parashtruar se vendimi nr.11494/03, datë 20.03.2003, i Gjykatës së Romës, Itali ka marrë formë të prerë duke u detyruar shoqëria "Albtelekom" SH.A. t'i paguajë "RAI-Radio Televisione Italiana" Spa shumën 15.529,76 Euro, interesat nga 15 maj 1999 deri në datën e pagesës, pagesat për shpenzimet 92,96 Euro, për të drejtat 826,33 Euro, për honoraret 1291,14 Euro, si dhe pagesat për aksesorët fiskalë dhe sigurimet e rimbursimet, shpenzime të përgjithshme sipas ligjit.

Në përfundim të hetimit gjyqësor, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 93, datë 20.07.2011 ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Rai-RadioTelevisionne Italiana për njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit Nr. 11494/03, datë 20.03.2003, të Gjykatës së Romës, Itali.
Në marrjen e vendimit gjykata e apelit arsyeton se: "*..rezulton se ekzistojnë pengesat që parashikohen në nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile, referuar nenit 394 në lidhje me nenin 399 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton që: "Sipas dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit italian dhe kjo përbën pengesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve ndërgjyqëse"*; - *"Provohen pretendimet nga personi i tretë Albtelekom Sh.a., për mos sigurimin e garancive të nevojshme për t'u mbrojtur gjatë gjykimit të mosmarrëveshjes nga gjykata e huaj; Kërkesë padia dhe fletëthirrjet për në gjyq nuk i janë njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt, e në kohë, për t'i dhënë atij mundësinë për t'u mbrojtur"*; - *"Vendimi i gjykatës së huaj objekt njohje nuk ka marrë formë të prerë sipas rregullave të legjislacionit të vendit të tij. Vendimi i gjykatës së huaj si më lart në pamundësi të njoftimit nuk është apeluar sipas ligjit të vendit ku është zhvilluar procedura e gjykimit"*; - *"Vendim i gjykatës së huaj është në kundërshtim me parimet bazë të legjislacionit shqiptar, pasi nuk rezulton e provuar ekzistenca e kontratës së porosisë e lidhur mes palëve e për pasojë nuk njihen të drejtat dhe detyrimet e palëve përcaktuar nga kjo kontratë"*;

Mbi rekurs të kërkuesit Rai-RadioTelevisionne Italiana, me anë të të cilit ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, për shkaqet e parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (shumica) me vendimi nr. 623, datë 27.11.2014 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 93, datë 20.07.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Kolegji Civil (shumica) arsyeton se:"….*Vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e mosrespektimit të neneve 10, 11, 14, 16, 29, 126 e 310 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilëve gjykata mbështet vendimin mbi faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, të marra në seancë gjyqësore, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që për rastin lidhen me ekzistencën ose jo të pengesave ligjore për njohjen dhe dhënien fuqi një vendimi të një gjykate të huaj, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë pjesëmarrësit në proces gjyqësor dhe zgjidh atë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. .... Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimit të gjykatës së apelit i mungon argumentueshmëria, që do të thotë se vendimi nuk përputhet plotësisht me të dhënat objektive të çështjes dhe për rrjedhojë është dhe i pambështetur në ligj....Gjithashtu, ky kolegj vlerëson se vendimit të gjykatës së apelit i mungon arsyetimi, ç'ka ka sjellë dhe mosdhënien e arsyeve ligjore të rrëzimit të kërkesës. Arsyetimi i vendimit është detyrim i sanksionuar në nenin 142/1 të Kushtetutës dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, mosrespektimi i të cilave pas sjell prishjen e tij... evidentohet se kjo gjykatë ka*

dalë me vendimmarrje pa bërë një analizë tërësore dhe objektive të fakteve dhe provave që mbështesin bazueshmërinë ose jo të kërkesës për njohjen e vendimit të një gjykate të huaj, konform kërkesave të nenit 126 dhe pikave 1 dhe 2 të nenit 310/II të Kodit të Procedurës Civile...."

Përsa i përket konstatimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (shumica), se vendimi i gjykatës së apelit është i paargumentuar dhe i pabazuar në prova, pakica, në shqyrtim të akteve proceduriale të dosjes gjyqësore, arrin në përfundimin se gjykata e apelit ka respektuar nenin 310 të K.Pr.Civile, duke bërë një analizë të fakteve dhe provave që ndodhen në dosje në respektim edhe të nenin 10 të K.Pr.Civile që parashikon "*gjykata jep vendimin e saj vetëm mbi fakte që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor."*

Gjykata e apelit në zbatim të nenit 394 në lidhje me nenin 399 të K.Pr.Civile ka argumentuar qëndrimin e saj lidhur me pengesat ligjore mbi njohjen e vendimit të gjykatës së huaj duke konstatuar se kërkesëpadia dhe letërthirrjet për në gjyq nuk i janë njoftuar të padituri në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë për t'i dhënë mundësi për tu mbrojtur; vendimi i gjykatës së huaj nuk ka marrë formë të prerë sipas rregullave të legjislacionit të vendit të tij pasi në pamundësi për tu njoftuar nuk është apeluar sipas ligjit të vendit..

Si gjyqtare në pakicë vlerësoj se gjykata e apelit ka zbatuar kërkesat e nenit Neni 394 të K.Pr.Civile, i cili parashikon: "*Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur.... dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar"*.

Në analizë të kësaj dispozite, kur themi vendimi i një shteti të huaj "*nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar*", kemi parasysh që vendimi i huaj, i dhënë në zbatim të së drejtës materiale e procedurale përkatëse nga gjykata e shtetit të huaj (konkretisht nga Gjykata Italiane),, të mos bjerë ndesh me parimet bazë të së drejtës materiale e procedurale, të Republikës së Shqipërisë.

Në referim të nenit 394/dh të K.Pr.Civile, në rastet kur nuk i jepet fuqi vendimit të një shteti të huaj pasi ai "*nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar"*, është e nevojshme që disponimet e vendimit gjyqësor të shtetit të huaj të mos vijnë në kundërshtim me principet bazë të së drejtës së shtetit shqiptar. Kur flasim për parime bazë të legjislacionit shqiptar, ligjvënësi ndër të tjera, ka parasysh ato parime të parashikuara në K.Pr.Civile, që i garantojnë palëve barazinë e aksesin në gjykim, si pjesë integrale të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ndërkohë që nuk ka rëndësi përmbajtja specifike e normave juridike të së drejtës së huaj që zbatohen nga gjykata e huaj, pasi në një proces njohjeje dhe ekzekutimi të një vendimi të huaj, Gjykatat shqiptare nuk mund të ri-vlerësojnë këto norma të legjislacionit të huaj nga pikapamja përmbajtësore, dhe as të rishikojnë çështjen e zgjidhur prej tyre në themel, e rëndësishme është që efektet që rrjedhin nga njohja dhe dhënia fuqi e vendimit gjyqësor të një shteti të huaj, të mos vijnë në kundërshtim me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Për sa më sipër, dhe në rrethanat kur përpara gjykatës së apelit është provuar se gjykimi në mungesë i palës së tretë "Albtelecom" sh.a. është bërë në kundërshtim me rregullat procedurale mbi njoftimin e palëve dhe garantimin e pjesëmarrje së tyre në proces, në zbatim të nenit 394 të K.Pr.Civile, këtij të fundit nuk i është garantuar nga gjykata e huaj e drejta themelore për një proces të rregullt gjyqësor. Konstatohet se fletëthirrja dhe vendimi i kundërdrejtohet një subjekti

të emërtuar “Telecom Albanian International Service Department”, ndërkohë që emri i subjektit të regjistruar në QKR është “Albtelecom” sh.a. Bazuar edhe në nenin 4 të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, sipas të cili *“...[t]regtari dhe shoqëritë tregtare e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën emrin e regjistruar...”*, referimi në aktet e gjykatës ndaj një subjekti me emërtim të ndryshëm, bën që ky akt t`i jetë drejtuar një subjekti që është gjithashtu ligjërisht i ndryshëm nga pala e tretë, shoqëria “Albtelecom” sh.a. Mangësi të tilla në identifikimin e subjektit dhe adresës përkatëse për kryerjen e njoftimeve, kanë shkaktuar edhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të personit të tretë “Albtelecom” sh.a., duke i mohuar këtij të fundit jo vetëm të drejtën për t’u dëgjuar e mbrojtur përpara gjykatës së huaj, por mbi të gjitha, të drejtën për të ushtruar ankim në përputhje me kërkesat e ligjit procedural.

Gjykata e apelit në zbatim të drejtë të nenit 327 të Kodit të Procedurës Italiane ka arsyetuar se vendimi gjyqësor i huaj nuk ka marrë formë të prerë pasi afatet e dekandencës së ankimit apo rekursit nuk zbatohet në kushtet kur provohet se pala në mungesë nuk ka pasur dijeni për gjykimin për shkak të mosnjoftimit të padisë dhe mosnjoftimit të akteve.

Për sa më sipër, ndryshe nga mendimi i shumicës, vlerësoj se vendimi i gjykatës së apelit është tërësisht i argumentuar, i dhënë në respektim të ligjit material e procedural, e për këtë arsye, vendimi nr. 93, datë 20.07.2011 i Gjykatës së Apelit Tiranë, duhet të lihet në fuqi.

GJYQTARE
MIRELA FANA